



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 290 Prot.

Tiranë, më 17/03/2023

VENDIM

Nr. 19 DATË 17/03/2023

MBI

**“PROPOZIMET PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE UDHËHEQËSIT SHKENCORË
PËR CIKLIN E TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË NË MUZIKOLOGJI” NË
FAKULTETIN E MUZIKËS PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, në “Rregulloren e funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, pasi shqyrtoi shkresën nr. 164/1 prot., datë 13.03.2023 të FM dhe nr. 290 prot. datë 13.03.2023 të UART, nëpërmjet të cilës përcillen propozimet për kuotat e pranimi dhe udhëheqësit shkencorë për ciklin e tretë të studimit “Doktoratë në Muzikologji”, pasi u njoh me relacionin e Rektorit dhe pas diskutimeve,

V E N D O S I:

1. Revokimin e VSA Nr. 7, datë 09.02.2023, “Mbi propozimet për kuotat e pranimi dhe udhëheqësit shkencorë për ciklin e tretë të studimit “Doktoratë në Muzikologji”, në Fakultetin e Muzikës për vitin akademik 2023-2024”.
2. Pranimin e propozimit për 25 (njëzet e pesë) kuota pranimi në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë në Muzikologji” si dhe të listës emërore të personelit akademik që do të jenë udhëheqës shkencorë (sipas materialit bashkëlidhur) në këtë cikël studimi në Fakultetin e Muzikës, UART.
3. Ky vendim t’i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për miratim përfundimtar.
4. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genc FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

